



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**

**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS**  
**TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL**

## **RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020** **I KOMISIONIT MBIKQYRËS**

**PËR ZBATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE PLANIT TË VEPRIMIT**  
**PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT DHE KRIMEVE EKONOMIKE**

Autor: Koordinatorinacional i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional

Janar 2020, Prishtinë

## PËRMBAJTJA

Parathënie.....	3
Hyrje.....	4
PJESA E PARË: Raporti i përgjithshëm.....	5
1 Korrupsioni dhe krimet ekonomike.....	6
1.1 Kallëzimet penale.....	6
1.2 Subjektet parashtruese të kallëzimeve penale.....	7
1.3 Mënyra e procedimit të personave.....	8
1.4 Informatat PPN.....	9
1.5 Subjektet parashtruese të informatave PPN.....	10
2 Korrupsioni.....	11
2.1 Kallëzimet penale.....	11
2.2 Subjektet parashtruese të kallëzimeve penale.....	12
2.3 Mënyra e procedimit të personave.....	13
2.4 Informatat PPN.....	14
2.5 Subjektet parashtruese të informatave PPN.....	15
3 Krimet ekonomike.....	16
3.1 Kallëzimet penale.....	16
3.2 Subjektet parashtruese të kallëzimeve penale.....	17
3.3 Mënyra e procedimit të personave.....	18
3.4 Informatat PPN.....	19
3.5 Subjektet parashtruese të informatave PPN.....	20
PJESA E DYTË: Raporti për Njësitin në Prokurorinë Themelore të Prishtinës.....	21
4 Korrupsioni dhe krimet ekonomike.....	22
4.1 Kallëzimet penale.....	22
4.2 Subjektet parashtruese të kallëzimeve penale.....	23
4.3 Mënyra e procedimit të personave.....	24
4.4 Informatat PPN.....	25
4.5 Subjektet parashtruese të informatave PPN.....	26
5 Korrupsioni.....	27
5.1 Kallëzimet penale.....	27
5.2 Subjektet parashtruese të kallëzimeve penale.....	28
5.3 Mënyra e procedimit të personave.....	29
5.4 Informatat PPN.....	30
5.5 Subjektet parashtruese të informatave PPN.....	31
6 Krimet ekonomike.....	32
6.1 Kallëzimet penale.....	32
6.2 Subjektet parashtruese të kallëzimeve penale.....	33
6.3 Mënyra e procedimit të personave.....	34
6.4 Informatat PPN.....	35
6.5 Subjektet parashtruese të informatave PPN.....	36
PJESA E TRETË	
7 Përfundime.....	37
7.1 Konstatime.....	37
7.2 Rekomandime.....	41

## PARATHËNIE

Në kuadër të realizimit të obligimeve dhe detyrave të parashikuara në Planin strategjik 2013-2015 të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më 10-11 maj 2013, nën udhëheqjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ishte organizuar një takim pune, i njohur si *“Takimi i Prevallës”*, me të gjithë aktorët vendorë<sup>1</sup> dhe ndërkombëtarë, me qëllim e përbashkët për krijimin e një mekanizmi përcjellës për zbulimin, hetimin, ndjekjen, gjykimin dhe ndëshkimin e kryesve të veprave penale karakteristike<sup>2</sup>.

Këshilli Prokurorial i Kosovës kishte krijuar bazën e të dhënave për regjistrimin e të dhënave për veprat penale karakteristike dhe në fund të vitit 2013 kishte publikuar Raportin e parë vjetor për vitin 2013.

Nga ky raport, KPK-ja ka identifikuar dy çështje që kërkonin angazhim shtesë: 1. Lëndët e korrupsionit, të cilat përbënin më shumë se 50% lëndëve nga numri i përgjithshëm i veprave penale karakteristike, dhe 2. Sekuestrimi dhe konfiskimi.

1. Lidhur me lëndët e korrupsionit, KPK-ja në vitin 2013 kishte miratuar Planin e veprimit nr.1285/2013<sup>3</sup> për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit dhe kishte caktuar një koordinator për mbikëqyrjen e zbatimit të planit<sup>4</sup>;
2. Këshilli Prokurorial i Kosovës në vitin 2014 kishte nënshkruar Memorandumin e bashkëpunimit nr.231/2014<sup>5</sup> me institucionet relevante për themelimin dhe funksionalizimin e Koordinatorit kombëtar për luftimin e krimeve ekonomike, gjegjësisht, për ndjekjen e kryesve të veprave penale, sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.<sup>6</sup>

Këshilli Prokurorial i Kosovës, përkundër angazhimeve në këto dy tema, ka konstatuar nevojën për një ngritje të angazhimit dhe sinkronizim të punëve në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

## HYRJE

Këshilli Prokurorial i Kosovës në fund të vitit 2015 ka hartuar Planin strategjik trevjeçar (2016-2018) për ngritjen e efikasitetit në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, përmes të të cilit

<sup>1</sup> Institucionet dhe subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor.

<sup>2</sup> Armët, drogat, kontrabandimi me migrantë, krimi organizuar, korrupsioni, shpërlarja e parasë, trafikimi i njerëzve dhe fshehja e dokumenteve të identifikimit të migrantëve, ndërsa në vitin 2014 është shtuar grupi i veprave penale të krimeve ekonomike.

<sup>3</sup> Shih: [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1285.2013-Plani\\_i\\_Veprimit\\_per\\_Rritjen\\_e\\_Efikasitetit\\_te\\_Sistemit\\_Prokurorial.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1285.2013-Plani_i_Veprimit_per_Rritjen_e_Efikasitetit_te_Sistemit_Prokurorial.pdf)

<sup>4</sup> Shih: [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1363.2013-Vendim-Laura\\_Pula\\_emerohet\\_Kordinatore\\_nacionale\\_.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1363.2013-Vendim-Laura_Pula_emerohet_Kordinatore_nacionale_.pdf)

<sup>5</sup> Shih: [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.231.2014\\_-\\_Memorandum\\_Bashkepunimi\\_fin.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.231.2014_-_Memorandum_Bashkepunimi_fin.pdf)

<sup>6</sup> Shih: [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1512.2013\\_-\\_Vendim\\_-\\_per\\_Shqipdon\\_Fazliu\\_-\\_Kordinator\\_Kombetare\\_-\\_KPK.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1512.2013_-_Vendim_-_per_Shqipdon_Fazliu_-_Kordinator_Kombetare_-_KPK.pdf)

synohej ngritja e efikasitetit dhe zvogëlimi i lëndëve të pazgjidhura të veprave penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike. Plani strategjik përmban disa qëllime, por duke mos u kufizuar, si: zvogëlimi i numrit të lëndëve të pazgjidhura, objekt i kësaj strategjie; rritja e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja; ngritja e nivelit të bashkëpunimit me institucione; ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve të specializuara dhe llogaridhënia dhe transparenca.

Analiza e të dhënave statistikore për lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike në kuadër të Prokurorisë Themelore të Prishtinës ka rezultuar me nevojën për krijimin e një njësie të veçantë në kuadër të dy departamenteve (Departamentit për Krime të Rënda dhe Departamentit të Përgjithshëm), të cilat nga 1 janari 2016 do të merreshin me lëndët e reja të korrupsionit dhe krimeve ekonomike. Ndërsa prokurorët e tjerë, sipas afateve të përcaktuara në planin strategjik, do të zgjidhnin vetëm rastet e pazgjidhura (të mbetura) të korrupsionit dhe krimeve ekonomike. Për më tej, në planin strategjik, në bazë të analizës statistikore të lëndëve, është përcaktuar edhe numri i prokurorëve që do të angazhohen në këtë njësi të re.

Në planin strategjik ishin paraparë edhe mekanizmat mbikëqyrës për zbatimin e strategjisë. Këto mekanizëm e përbëjnë:

1. Komisionin Mbikëqyrës, i cili ka për detyrë të vlerësojë veprimet e ndërmarra nga prokurorët e prokurorive themelore dhe PSRK-së në luftimin e korrupsionit dhe
2. Koordinatorin kombëtar për luftimin e krimeve ekonomike për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Theksojmë se Koordinatorin kombëtar harton raporte të veçanta për KPK-në lidhur me performancën e prokurorive në aspektin sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së paligjshme.

Në kuadër të këtij plani strategjik është inkorporuar Plani i veprimit, përmes të të cilit është krijuar metodologjia e punës për rritjen e efikasitetit në trajtimin e lëndëve të korrupsionit, krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme.

Komisioni mbikëqyrës në baza tremujore ka hartuar raporte periodike, të cilat i ka proceduar në Këshillin Prokurorial për shqyrtim dhe miratim. Raportet përmbanin të dhëna statistikore dhe analitike lidhur me gjendjen e rasteve për veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike në tërë sistemin prokurorial dhe në veçanti përmbanin të dhëna për gjendjen në Njësitin në Prokurorinë Themelore të Prishtinës.

Njëjtë si në raportet paraprake, edhe ky raport përmban strukturën, kronologjinë dhe të dhënat statistikore në sistemin prokurorial në përgjithësi dhe për Njësitin në veçanti.

Në kuadër të përfundimeve, në pjesën e fundit, janë përshkruar konstatimet kryesore, të cilat pasqyrojnë gjendjen dhe performancën e sistemit prokurorial dhe të Njësitit në Prokurorinë Themelore të Prishtinës për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike. Ndërsa në fund të raportit janë ofruar rekomandimet konkrete, të cilat mund të ndikojnë në rritjen e efikasitetit në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

**PJESA E PARË**  
**RAPORTI I PËRGJITHSHËM**

PJESA E PARË  
SISTEMI PROKURORIAL I KOSOVËS

## 1. KORRUPSIONI DHE KRIMET EKONOMIKE

### 1.1 KALLËZIMET PENALE

Prokuroritë në fillim të vitit 2020 kishin trashëguar nga periudha e kaluar 636 kallëzime penale me 1386 persona të përfshirë në veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, ndërsa gjatë vitit 2020 kanë pranuar 759 kallëzime penale me 1378 persona.

Nga tërësia prej **1395** kallëzimesh penale në punë me **2764** persona, prokuroritë gjatë vitit 2020 kanë proceduar (*kryer/zgjidhur*) **654** kallëzime penale me **1175** persona, ndërsa në fund të vitit 2020, ngarkesa me lëndë përbën **741** kallëzime penale me **1589** persona (*shih figurën 1*).

		RASTET E TRASHËGUARA		RASTET E PRANUARA TË REJA		GJITHSEJ RASTET NË PUNË		RASTET E PROCEDUARA (KRYERA/ZGJIDHURA)		NGARKESA ME LËNDËT E MBETURA	
		A		B		C(A-B)		D		E (C-D)	
		KP	P	KP	P	KP	P	KP	P	KP	P
1	KORRUPSIONI	267	800	379	778	646	1578	329	697	317	881
2	KRIMET EKONOMIKE	369	586	380	600	749	1186	325	478	424	708
Gjithsej:		<b>636</b>	<b>1386</b>	<b>759</b>	<b>1378</b>	<b>1395</b>	<b>2764</b>	<b>654</b>	<b>1175</b>	<b>741</b>	<b>1589</b>

Figura 1

#### Aspekte krahasimore:

Raporti krahasimor në mes rasteve të pranuar të reja dhe të proceduara në vitin 2020:

- Janë proceduar **86.17** të kallëzimeve penale, Janë proceduar **85.27%** të personave.

Raporti krahasimor në mes të rasteve në punë dhe të proceduara në vitin 2020:

- Janë proceduar **46.88%** të kallëzimeve penale,
- Janë proceduar **42.51%** të personave.

Në fund të vitit 2020 rezulton se ngarkesa me lëndë është rritur për 105 kallëzime penale (apo **+16.51%**) dhe 203 persona (apo **+14.65%**) në raport me gjendjen e kallëzimeve penale me persona në fillim të vitit për veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

### 1.2 SUBJEKTET PARASHTRUESE TË KALLËZIMEVE PENALE (KORR & E)

Subjektet parashtruese të rasteve penale gjatë vitit 2020 kanë parashtruar nëpër prokurori **759** kallëzime penale me **1378** persona të përfshirë në veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike (*shih figurën 2*).

SUBJEKTET		SPECIALE		PRISHTINË		PRIZREN		PEJË		GJILAN		MITROVICË		FERIZAJ		GJAKOVË		GJITHSEJ:	
		R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P
1	AKK	2	2	45	89	7	16	16	16	6	7			3	3	5	5	84	138
2	APK	0	0	1	1	0	0	0	0	7	7	0	0	4	4	0	0	12	12
3	ATK	0	0	17	17	12	17	2	2	4	23	1	1	6	7	5	7	47	74
4	IPK			10	14	1	2			1	1	1	5	3	5			16	27
5	OAK			1	1	1	1	1	1							1	1	4	4
6	DG			35	37	5	6	19	22	5	5			4	4			68	74
7	PK	2	11	59	125	52	94	28	50	100	157	19	31	38	58	26	37	324	563
8	TP			13	15													13	15
9	AGJ	1	1															1	1
10	EPK	11	32	16	44	7	21	5	26			10	19	6	14			55	156
11	PV			9	17	2	4	1	1									12	22
12	Q	42	139	5	9	15	34	7	7			4	6	2	2			75	197
13	ID	1	7	15	36	20	34			7	8			3	6	2	4	48	95
<b>Gjithsej</b>		<b>59</b>	<b>192</b>	<b>226</b>	<b>405</b>	<b>122</b>	<b>229</b>	<b>79</b>	<b>125</b>	<b>130</b>	<b>208</b>	<b>35</b>	<b>62</b>	<b>69</b>	<b>103</b>	<b>39</b>	<b>54</b>	<b>759</b>	<b>1378</b>

Figura 2

Nivelin më të lartë të kallzimeve penale të parashtruara gjatë vitit 2020 rezulton ta kenë institucionet e specializuara me **82.21%** të kallzimeve penale dhe **77.21%** të personave, ndërsa niveli më i ulët i parashtrimin të kallzimeve penale i adresohet vetiniciativës së prokurorit me gjithsej **1.58%** të kallzimeve penale dhe **1.60%** të personave (shih figurën 3).




Figura 3

### 1.3 MËNYRA E PROCEDIMIT (kryerjes/zgjidhjes) TË PERSONAVE (KORR & E)

Prokuroritë gjatë vitit 2020 kanë proceduar (zgjidhur/kryer) rastet e **1175** personave të përfshirë në kallzimet penale për veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike (shih figurën 4).

	Numri persona	Hudhje e kallzimit penal	Transferim procedurës në shtetin tjetër	Bashkimi i procedurës	Pushimi i hetimit	Aktakuzë për dhënien e urdhrin ndëshkimit	Aktakuzë e drejtpërdrejtë	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve
1	KORR	697	270	4	178		15	230
2	E	478	86	1	69	3	60	256
<b>Gjithsej:</b>		<b>1175</b>	<b>356</b>	<b>1</b>	<b>247</b>	<b>3</b>	<b>75</b>	<b>486</b>

Figura 4

Nga tërësia e rasteve të proceduara për persona gjatë vitit 2020 rezulton se aktakuzat e ngritura me **48.00%** të personave përbëjnë nivelin sipas mënyrës së procedimit të rasteve ndaj personave të përfshirë në veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike (shih figurën 5).




Figura 5

#### 1.4 INFORMATAT PPN (KORR & E)

Prokuroritë në fillim të vitit 2020 kishin të trashëguara nga periudha e kaluar 799 Informata PPN me 1362 persona të përfshirë në veprat e pretenduara penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, ndërsa gjatë vitit 2020 kanë pranuar 443 Informata PPN me 581 persona.

Nga tërësia prej **1242** Informata PPN në punë me **1943** persona, prokuroritë gjatë vitit 2020 kanë mbyllur **442** Informata PPN me **706** persona ndërsa, në fund të vitit 2020 ngarkesa me lëndë përbënë **800** Informata PPN me **1237** persona (shih figurën 6).

		RASTET E TRASHËGUAR A		RASTET E PRANUARA TË REJA B		GJITHSEJ RASTET NË PUNË C(A+B)		RASTET E MBYLLURA D		NGARKESA ME LËNDËT E MBETURA E (C-D)	
		A		B		C(A+B)		D		E (C-D)	
		PPN	P	PPN	P	PPN	P	PPN	P	PPN	P
1	KORRUPSIONI	524	1021	327	460	851	1481	298	549	553	932
2	KRIMET EKONOMIKE	275	341	116	121	391	462	144	157	247	305
Gjithsej:		<b>799</b>	<b>1362</b>	<b>443</b>	<b>581</b>	<b>1242</b>	<b>1943</b>	<b>442</b>	<b>706</b>	<b>800</b>	<b>1237</b>

Figura 6



## Aspekte krahasimore:

Raporti krahasimor në mes rasteve të pranuar të reja dhe të mbyllura në vitin 2020:

- Janë proceduar **99.77** të informatave PPN,
- Janë proceduar **121.51%** të personave.

Raporti krahasimor në mes tërësisë së rasteve në punë dhe rasteve të mbyllura në vitin 2020:

- Janë proceduar **35.59%** të informatave PPN,
- Janë proceduar **36.34%** të personave.

Në fund të vitit 2020 rezulton se ngarkesa me lëndë është rritur për një informatë PPN (apo **+0.13%**), ndërsa është zvogëluar për 125 persona (apo **-9.18%**) në raport me gjendjen e informatave PPN me persona në fillim të vitit për veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

## 1.5 SUBJEKTET PARASHTRUESE TË INFORMATAVE PPN (KORR & E)

Subjektet e ndyshme kanë parashtruar gjatë vitit 2020 nëpër prokurori **443** informata PPN të reja me **581** persona, të përfshirë në veprat e pretenduara penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike (*shih figurën 7*).

SUBJEKTET	SPECIALE		PRISHTINË		PRIZREN		PEJË		GJILAN		MITRO		FERIZAJ		GJAKOVË		GJITHSEJ:		
	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	
1	AKK	1	1	4	4					1	1			1	1			7	7
2	ATK			2	2													2	2
3	DG			7	7	1	1	6	7									14	15
4	NJIF	1	1															1	1
5	IPK	3	12	2	2	1	1	2	2				1	1				9	18
6	OAK			1	1													1	1
7	TP			13	13													13	13
8	AGJ	1	1															1	1
9	PK	15	19	49	55	21	31	93	113	1	3			2	2	5	5	187	229
10	EPK			40	58	6	6	9	15					1	1			56	80
11	PV			3	3	1	1	1	1									5	5
12	ID			60	91	4	4			1	1					7	7	72	103
13	Q	8	10	37	56	3	3	27	37									75	107
<b>Gjithsej</b>		<b>29</b>	<b>44</b>	<b>218</b>	<b>292</b>	<b>37</b>	<b>47</b>	<b>138</b>	<b>175</b>	<b>3</b>	<b>5</b>			<b>5</b>	<b>5</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>443</b>	<b>581</b>

Figura 7

Nivelin më të lartë të parashtrimit të rasteve rezulton ta kenë institucionet e specializuara me **65.69%** të informata PPN dhe **63.17%** të personave, ndërsa niveli më i ulët i parashtrimit të rasteve i adresohet vetiniciativës së prokurorit me gjithsej **1.13%** të informatave PPN dhe **0.86%** të personave (*shih figurën 8*).




Figura 8

## 2. KORRUPSIONI

### 2.1 KALLËZIMET PENALE (KORR)

Prokuroritë në fillim të vitit 2020 kishin trashëguar nga periudha e kaluar **267** kallëzime penale me **800** persona për veprat penale të korrupsionit, ndërsa gjatë vitit 2020 kanë pranuar **379** kallëzime penale të reja me **778** persona.

Nga tërësia prej **646** kallëzimesh penale në punë me **1578** persona, prokuroritë gjatë vitit 2020 kanë proceduar (*kryer/zgjidhur*) **329** kallëzime penale me **697** persona, ndërsa ngarkesa me lëndë të mbetura në fund të vitit përbën **317** kallëzime penale me **881** persona (*shih figurën 9*).

PROKURORIA		RASTET E TRASHËGUARA		RASTET E PRANUARA TË REJA		GJITHSEJ RASTET NË PUNË		RASTET E PROCEDUARA (KRYERA/ZGJIDHURA)		NGARKESA ME LËNDËT E MBETURA	
		A		B		C (A+B)		D		E (C-D)	
		KP	P	KP	P	KP	P	KP	P	KP	P
1	SPECIALE	26	173	57	177	83	350	39	155	44	195
2	PRISHTINË	104	336	117	233	221	569	115	238	106	331
3	PRIZREN	25	80	65	125	90	205	61	116	29	89
4	PEJË	4	6	36	62	40	68	19	30	21	38
5	GJILAN	7	15	34	59	41	74	33	66	8	8
6	MITROVICË	76	125	24	48	100	173	17	22	83	151
7	FERIZAJ	15	44	29	48	44	92	30	51	14	41
8	GJAKOVË	10	21	17	26	27	47	15	19	12	28
<i>GJITHSEJ:</i>		<b>267</b>	<b>800</b>	<b>379</b>	<b>778</b>	<b>646</b>	<b>1578</b>	<b>329</b>	<b>697</b>	<b>317</b>	<b>881</b>

Figura 9

#### Aspekte krahasimore:

Raporti krahasimor në mes rasteve të pranuar të reja dhe të proceduara në vitin 2020:

- Janë proceduar **86.81** të kallëzimeve penale,
- Janë proceduar **89.59%** të personave.

Raporti krahasimor në mes të rasteve në punë dhe të proceduara në vitin 2020:

- Janë proceduar **50.93%** të kallëzimeve penale,
- Janë proceduar **44.17%** të personave.

Në fund të vitit 2020 rezulton se ngarkesa me lëndë është rritur për 50 kallëzime penale (apo **+18.73%**) dhe 81 persona (apo **+10.13%**) në raport me gjendjen e kallëzimeve penale me persona në fillim të vitit për veprat penale të korrupsionit.

## 2.2 SUBJEKTET PARASHTRUESE TË KALLËZIMEVE PENALE (KORR)

Subjektet parashtruese të rasteve penale gjatë vitit 2020 kanë parashtruar nëpër prokurori **379** kallëzime penale me **778** persona të përfshirë në veprat penale të korrupsionit (*shih figurën 10*).

SUBJEKTET	SPECIALE		PRISHTINË		PRIZREN		PEJË		GJILAN		MITROVICË		FERIZAJ		GJAKOVË		GJITHSEJ:	
	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P
1 AKK	2	2	45	89	7	16	16	16	6	7			3	3	5	5	84	138
2 APK									7	7			4	4			11	11
3 ATK			1	1													1	1
4 IPK			5	6					1	1	1	5	2	2			9	14
5 OAK			1	1													1	1
6 PK	2	11	21	45	19	23	10	15	14	37	9	18	12	21	10	17	97	187
7 TP			8	8													8	8
8 AGJ	1	1															1	1
9 EPK	11	32	11	29	6	20	3	24			10	19	4	11			45	135
10 PV			5	9	1	3	1	1									7	13
11 Q	40	124	5	9	12	29	6	6			4	6	1	1			68	175
12 ID	1	7	15	36	20	34			6	7			3	6	2	4	47	94
<i>Gjithsej</i>	57	177	117	233	65	125	36	62	34	59	24	48	29	48	17	26	379	778

Figura 10

Nivelin më të lartë të kallëzimeve penale të parashtruara gjatë vitit 2020 rezulton të kenë institucionet e specializuara me **67.81%** të kallëzimeve penale dhe **63.75%** të personave (*shih figurën 11*).




Figura 11

Legjenda:

AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit	OAK	Organi i administratës komunale	E	EULEX-i	EPK	E pranuar në kompetencë
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës	TP	Titullari i pronës - OP të dëmtuar	PK	Policia e Kosovës	APJ	Autoriteti Pjor i Kosovës
ATK	Administrata Tatimore Kosovës	IPK	Inspektorati Policor i Kosovës	D	Dogana e Kosovës	PV	Prokurori me vetiniciativë
Q	Të tjera (qytetari)	NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare	ID	I dëmtuari	AGJ	Auditori Gjeneral

### 2.3 MËNYRA E PROCEDIMIT (kryerja/zgjidhja) TË PERSONAVE (KORR)

Prokuroritë gjatë vitit 2020 kanë proceduar (kryer/zgjidhur) rastet për 697 persona të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale të korrupsionit (shih figurën 12).

PROKURORIA	PERSONA	Hudhje e kallëzimit penal	Bashkimi i procedurës	Pushimi hetimit	Aktakuzë e drejtpërdrejtë	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve
1 SPECIALE	155	79	2	23		51
2 PRISHTINË	238	78		65		95
3 PRIZREN	116	69		26	2	19
4 PEJË	30	6		12	2	10
5 GJILAN	66	9		38	2	17
6 MITROVICË	22	5		2	4	11
7 FERIZAJ	51	24		10	3	14
8 GJAKOVË	19		2	2	2	13
Gjithsej:	697	270	4	178	15	230

Figura 12

Nga tërësia e rasteve të proceduara për persona gjatë vitit 2020 nivelin më të lartë rezulton ta ketë hudhja e kallëzimeve penale me 38.74% të personave të përfshirë në veprat penale të korrupsionit (shih figurën 13).




Figura 13

## 2.4 INFORMATAT PPN (KORR)

Prokuroritë në fillim të vitit kishin trashëguar nga periudha e kaluar 524 informata PPN me 1021 persona të përfshirë në veprat penale të korrupsionit, ndërsa gjatë vitit 2020 kanë pranuar 327 informata të reja PPN me 460 persona.

Nga tërësia prej 851 informatash PPN me 1481 persona në punë gjatë vitit 2020, prokuroritë kanë mbyllur 298 informata PPN me 549 persona, ndërsa në fund të vitit 2020, ngarkesa me lëndë përbënë 553 informata PPN me 932 persona (*shih figurën 14*).

PROKURORIA	RASTET E TRASHËGUARA		RASTET E PRANUARA TË REJA		GJITHSEJ RASTET NË PUNË		RASTET E MBYLLURA		NGARKESA ME LËNDËT E MBETURA	
	A		B		D (A+B+C)		E		F (D-E)	
	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P
1   SPECIALE	48	135	28	43	76	178	18	57	58	121
2   PRISHTINË	283	495	180	254	463	749	164	298	299	451
3   PRIZREN	29	56	26	36	55	92	25	33	30	59
4   PEJË	28	77	76	108	104	185	57	106	47	79
5   GJILAN	1	4	3	5	4	9	2	5	2	4
6   MITROVICË	65	133			65	133	5	6	60	127
7   FERIZAJ	29	58	3	3	32	61	17	29	15	32
8   GJAKOVË	41	63	11	11	52	74	10	15	42	59
<i>GJITHSEJ:</i>	<b>524</b>	<b>1021</b>	<b>327</b>	<b>460</b>	<b>851</b>	<b>1481</b>	<b>298</b>	<b>549</b>	<b>553</b>	<b>932</b>

Figura 14

### Aspekte krahasimore:

Raporti krahasimor në mes **rasteve të pranuar të reja** dhe **të mbyllura** në vitin 2020:

- Janë proceduar **91.13** të informatave PPN,

- Janë proceduar **119.35%** të personave.

Raporti krahasimor në mes **tërësisë së rasteve në punë** dhe **rasteve të mbyllura** në vitin 2020:

- Janë proceduar **35.02%** të Informatave PPN,
- Janë proceduar **37.07%** të personave.

Në fund të vitit 2020 rezulton se ngarkesa lëndë është rritur për 29 informata PPN (apo **+5.53%**), ndërsa është zvogëluar për 89 persona (apo **-8.72%**) në raport me gjendjen e informatave PPN me persona në fillim të vitit për veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

## 2.5 PARASHTRUESIT E INFORMATAVE PPN (KORR)

Subjektet gjatë vitit 2020 kanë parashtruar **327** informata PPN me **460** persona të përfshirë në veprat penale të korrupsionit (*shih figurën 15*).

SUBJEKTET	SPECIALE		PRISHTINË		PRIZREN		PEJË		GJILAN		MITROVICË		FERIZAJ		GJAKOVË		GJITHSEJ:	
	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P
AKK	1	1	3	3					1	1			1	1			6	6
NJIF	1	1															1	1
IPK	3	12	2	2	1	1	2	2					1	1			9	18
EPK			38	56	6	6	9	15					1	1			54	78
OAK			1	1													1	1
PK	14	18	34	40	11	21	37	53	1	3					4	4	101	139
TP			12	12													12	12
AGJ	1	1															1	1
PV					1	1	1	1									2	2
ID			57	88	4	4			1	1					7	7	69	100
Q	8	10	33	52	3	3	27	37									71	102
	28	43	180	254	26	36	76	108	3	5			3	3	11	11	327	460

Figura 15

Nivelin më të lartë të informatave PPN për veprat penale të korrupsionit, të parashtruara gjatë vitit 2020, rezulton të kenë institucionet e specializuara me **56.57%** të informatave PPN dhe **55.56%** të personave ndërsa, niveli më i ulët i parashtrimit të Informatave PPN i adresohet vetiniciativës së prokurorit me gjithsej **0.61%** të kallëzimeve penale dhe **10.43%** të personave (*shih figurën 16*).





Figura 16

Legjenda:

AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit	OAK	Organi i administratës komunale	E	EULEX-i	EPK	E pranuar në kompetencë
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës	TP	Titullari i pronës - OP të dëmtuar	PK	Policia e Kosovës	APJ	Autoriteti Pujor i Kosovës
ATK	Administrata Tatimore Kosovës	IPK	Inspektorati Policor i Kosovës	D	Dogana e Kosovës	PV	Prokurori me vetiniciativë
Q	Të tjerë (qytetari)	NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare	ID	I dëmtuari	AGJ	Auditori Gjeneral

### 3. KRIMET EKONOMIKE

#### 3.1 KALLËZIMET PENALE (E)

Prokuroritë në fillim të vitit 2020 kishin trashëguar nga periudha e kaluar **369** kallëzime penale me **586** persona për veprat penale të krimeve ekonomike, ndërsa gjatë vitit 2020 kanë pranuar **380** kallëzime penale të reja me **600** persona.

Nga tërësia prej **749** kallëzimesh penale në punë me **1186** persona, prokuroritë gjatë vitit 2020 kanë proceduar (*kryer/zgjidhur*) **325** kallëzime penale me **478** persona, ndërsa ngarkesa me lëndë të mbetura në fund të vitit përbën **424** kallëzime penale me **708** persona (*shih figurën 17*).

PROKURORIA	RASTET E TRASHËGUARA		RASTET E PRANUARA TË REJA		GJITHSEJ RASTET NË PUNË		RASTET E PROCEDUARA (KRYERA/ZGJIDHURA)		NGARKESA ME LËNDËT E MBETURA		
	A		B		C(A+B)		D		E (C-D)		
	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	
1	SPECIALE	2	26	2	15	4	41	1	9	3	32
2	PRISHTINË	141	201	109	172	250	373	81	111	169	262
3	PRIZREN	22	37	57	104	79	141	56	94	23	47
4	PEJË	20	32	43	63	63	95	34	47	29	48
5	GJILAN	6	11	96	149	102	160	87	107	15	53
6	MITROVICË	148	211	11	14	159	225	13	19	146	206
7	FERIZAJ	17	41	40	55	57	96	41	71	16	25
8	GJAKOVË	13	27	22	28	35	55	12	20	23	35
<i>GJITHSEJ:</i>		<b>369</b>	<b>586</b>	<b>380</b>	<b>600</b>	<b>749</b>	<b>1186</b>	<b>325</b>	<b>478</b>	<b>424</b>	<b>708</b>

Figura 17

### Aspekte krahasimore:

Raporti krahasimor në mes rasteve të pranuar të reja dhe të proceduara në vitin 2020:

- Janë proceduar **85.53** të kallëzimeve penale,
- Janë proceduar **79.67%** të personave.

Raporti krahasimor në mes të rasteve në punë dhe të proceduara në vitin 2020:

- Janë proceduar **43.39%** të kallëzimeve penale,
- Janë proceduar **40.30%** të personave.

Në fund të vitit 2020 rezulton se ngarkesa me lëndë është rritur për 55 kallëzime penale (apo **+14.91%**) dhe 122 persona (apo **+20.82%**) në raport me gjendjen e kallëzimeve penale me persona në fillim të vitit për veprat penale të krimeve ekonomike.

### 3.2 PARASHTRUESIT E KALLËZIMEVE PENALE (E)

Subjektet gjatë vitit 2020 kanë parashtruar **380** kallëzime penale me **600** persona të përfshirë në veprat penale të krimeve ekonomike (*shih figurën 18*).

SUBJEKTET	SPECIALE		PRISHTINË		PRIZREN		PEJË		GJILAN		MITROVICË		FERIZAJ		GJAKOVË		GJITHSEJ:	
	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P
APK			1	1													1	1
ATK			16	16	12	17	2	2	4	23	1	1	6	7	5	7	46	73
OAK					1	1	1	1							1	1	3	3
DG			35	37	5	6	19	22	5	5			4	4			68	74
IPK			5	8	1	2							1	3			7	13
EPK			5	15	1	1	2	2					2	3			10	21
PK			38	80	33	71	18	35	86	120	10	13	26	37	16	20	227	376
TP			5	7													5	7
PV			4	8	1	1											5	9
Q	2	15			3	5	1	1					1	1			7	22
ID									1	1							1	1
#	2	15	109	172	57	104	43	63	96	149	11	14	40	55	22	28	380	600

Figura 18

Nivelin më të lartë të kallëzimeve penale për veprat penale të krimeve ekonomike, të parashtruara gjatë vitit 2020, rezulton ta kenë institucionet e specializuara me **56.57%** të kallëzimeve penale dhe **96.58%** të personave, ndërsa niveli më i ulët i parashtrimt të kallëzimeve penale i adresohet vetiniciativës së prokurorit me gjithsej **1.32%** të kallëzimeve penale dhe **1.50%** të personave (*shih figurën 19*).






Figura 19

Legjenda:

AKK	Agjencioni Kundër Korrupsionit	OAK	Organi i administratës komunale	E	EULEX-i	EPK	E pranuar në kompetencë
AKP	Agjencioni Kosovë për Pronës	TP	Titullari i pronës - OP të dëmtuar	PK	Policia e Kosovës	APJ	Autoriteti Pyjor i Kosovës
ATK	Administrata Tatimore Kosovës	IPK	Inspektorati Policor i Kosovës	D	Dogana e Kosovës	PV	Prokurori me vetëiniciativë
Q	Të tjera (qytetari)	NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare	ID	IDëmtuari	AGJ	Auditori Gjeneral

### 3.3 MËNYRA E PROCEDIMIT (kryera/zgjidhja) TË PERSONAVE (E)

Prokuroritë gjatë vitit 2020 kanë proceduar (kryer/zgjidhur) rastet për 478 persona të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale të krimeve ekonomike (shih figurën 20).

PROKURORIA	Numri i personave	Hudhje e kallëzimit penal	Pushimi i hetimit	Transferimi i procedurës në shtetin tjetër	Bashkimi i procedurës	Aktakuzë për dhënien e urdhrin ndëshkimor	Aktakuzë e drejtpërdrejtë	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	
1	SPECIALE	9	6	3					
2	PRISHTINË	111	7	30	2	3	3	66	
3	PRIZREN	94	25	11	1		1	55	
4	PEJË	47	10	9			1	27	
5	GJILAN	107	6	5			49	47	
6	MITROVICË	19	8	1			1	9	
7	FERIZAJ	71	16	10			5	40	
8	GJAKOVË	20	8					12	
GJITHSEJ:		478	86	69	1	3	3	60	256

Figura 20

Nga tërësia e rasteve të proceduara për persona gjatë vitit 2020, nivelin më të lartë rezultojnë të kenë aktakuzat e ngritura me 66.74% të personave të përfshirë në veprat penale të krimeve ekonomike (shih figurën 21).

### Mënyra e procedimit të personave




Figura 21

### 3.4. INFORMATAT PPN (E)

Prokuroritë në fillim të vitit kishin trashëguar nga periudha e kaluar 275 informata PPN me 341 persona të përfshirë në veprat penale të krimeve ekonomike, ndërsa gjatë vitit 2020 kanë pranuar 116 informata të reja PPN me 121 persona.

Nga tërësia prej **391** informatash PPN me **462** persona në punë gjatë vitit 2020, prokuroritë kanë mbyllur **144** informata PPN me **157** persona, ndërsa në fund të vitit 2020 ngarkesa me lëndë përbënë **247** informata PPN me **305** persona (*shih figurën 22*).

PROKURORIA	RASTET E TRASHËGUARA		RASTET E PRANUARA TË REJA		GJITHSEJ RASTET NË PUNË		RASTET E MBYLLURA		NGARKESA ME LËNDËT E MBETURA	
	A		B		C(A+B)		D		D(C-D)	
	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P
1 PSRK	2	4	1	1	3	5			3	5
2 PRISHTINË	110	147	38	38	148	185	18	25	130	160
3 PRIZREN	38	38	11	11	49	49	41	41	8	8
4 PEJË	102	117	62	67	164	184	79	85	85	99
5 GJILAN			1	1	1	1	1	1		
6 MITROVICË										
7 FERIZAJ	22	34	2	2	24	36	4	4	20	32
8 GJAKOVË	1	1	1	1	2	2	1	1	1	1
GJITHSEJ:	<b>275</b>	<b>341</b>	<b>116</b>	<b>121</b>	<b>391</b>	<b>462</b>	<b>144</b>	<b>157</b>	<b>247</b>	<b>305</b>

Figura 22

#### Aspekte krahasimore:

Raporti krahasimor në mes rasteve të pranuar të reja dhe të mbyllura në vitin 2020:

- Janë proceduar **124.14** të Informatave PPN,
- Janë proceduar **129.75%** të personave.

Raporti krahasimor në mes tërësisë së rasteve në punë dhe rasteve të mbyllura në vitin 2020:

- Janë proceduar **36.83%** të Informatave PPN,
- Janë proceduar **33.98%** të personave.

Në fund të vitit 2020 rezulton se ngarkesa lëndë është zvogëluar për 28 informata PPN (apo -10.18%) dhe për 36 persona (apo -10.56%) në raport me gjendjen e informatave PPN me persona në fillim të vitit për veprat penale të krimeve ekonomike.

### 3.5 SUBJEKTET PARASHTRUESE TË INFORMATAVE PPN (E)

Subjektet gjatë vitit 2020 kanë parashtruar **116** informata PPN me **121** persona të përfshirë në veprat penale të krimeve ekonomike (*shih figurën 23*).

SUBJEKTET	SPECIALE		PRISHTINË		PRIZREN		PEJË		GJILAN		MITROVICË		FERIZAJ		GJAKOVË		GJITHSEJ:		
	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	R	P	
1	AKK			1	1													1	1
2	ATK			2	2													2	2
3	DG			7	7	1	1	6	7									14	15
4	EPK			2	2													2	2
5	PK	1	1	15	15	10	10	56	60				2	2	1	1		86	90
6	TP			1	1													1	1
7	PV			3	3													3	3
8	ID			3	3													3	3
9	Q			4	4													4	4
Gjithsej:		1	1	38	38	11	11	62	67				2	2	1	1		116	121

Figura 23

Nivelin më të lartë të informatave PPN për veprat penale të korrupsionit, të parashtruara gjatë vitit 2020, rezultojnë të kenë institucionet e specializuara me **91.38%** të informatave PPN dhe **92.74%** të personave, ndërsa niveli më i ulët i parashtrimit të informatave PPN i adresohet vetiniciativës së prokurorit me gjithsej **2.59%** të kallëzimeve penale dhe **2.48%** të personave (*shih figurën 24*).




Figura 24

Legjenda:

AKK	Agjencioni Kundër Korrupsionit	OAK	Organi i administratës komunale	E	EULEX-i	EPK	E pranuar në kompetencë
AKP	Agjencioni Kosovar i Pronës	TP	Titullari i pronës - OP të dëmtuar	PK	Policia e Kosovës	APJ	Autoriteti Pujor i Kosovës
ATK	Administrata Tatimore Kosovës	IPK	Inspektorati Policor i Kosovës	D	Dogana e Kosovës	PV	Prokurori me vetiniciativë
Q	Të tjera (qytetari)	NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare	ID	I Dëmtuari	AGJ	Auditori Gjeneral

**PJESA E DYTË**  
**PJESA E VEÇANTË**

**RAPORTI PËR NJËSITIN NË PROKURORINË**  
**THEMELORE TË PRISHTINËS**  
**VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT DHE KRIMEVE EKONOMIKE**

## 4 KORRUPSIONI DHE KRIMET EKONOMIKE

### 4.1 KALLËZIMET PENALE (KORR & E)

Njësiti <sup>7</sup> në fillim të vitit 2020 kishte trashëguar nga periudha e kaluar 230 kallëzime penale me 519 persona të përfshirë në veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, ndërsa gjatë vitit 2020 kanë pranuar si raste të reja 221 kallëzime penale me 376 persona, ndërsa ka dërguar në kompetencë 90 kallëzime penale me 147 persona.

Nga tërësia prej **361** kallëzimesh penale në punë me **748** persona në vitin 2020, Njësiti ka proceduar (zgjidhur/kryer) **194** kallëzime penale me **329** persona, ndërsa në fund vitit 2020, ngarkesa me raste përbëhet nga **167** kallëzime penale me **419** persona për veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike (shih figurën 25).

NJËSITI (PTH PRISHTINË)		RASTET E TRASHËGUARA		RASTET E PRANUARA TË REJA		TË DËRGUARA NË KOMPETENCË		GJITHSEJ RASTET NË PUNË		RASTET E PROCEDUARA (KRYERA/ZGJIDHURA)		NGARKESA ME LËNDËT E MBETURA	
		A		B		C		D (A+B-C)		E		F (E-F)	
		K.P	P	K. P	P	K P	P	K P	P	K.P	P	K.P	P
1	KORRUPSIONI	99	332	11 6	240	2 3	64	1 9 2	508	113	212	79	296
2	K. EKONOMIKE	131	187	10 5	136	6 7	83	1 6 9	240	81	117	88	123
Gjithsej:		<b>230</b>	<b>519</b>	<b>22 1</b>	<b>376</b>	<b>9 0</b>	<b>147</b>	<b>3 6 1</b>	<b>748</b>	<b>194</b>	<b>329</b>	<b>167</b>	<b>419</b>

Figura 25

#### Aspekte krahasimore:

Raporti krahasimor në mes rasteve të pranuar të reja dhe të proceduara në vitin 2020:

- Janë proceduar **87.78** të kallëzimeve penale,
- Janë proceduar **87.50%** të personave.

Raporti krahasimor në mes të rasteve në punë dhe të proceduara në vitin 2020:

- Janë proceduar **53.74%** të kallëzimeve penale,
- Janë proceduar **43.98%** të personave.

<sup>7</sup> Njësiti në Prokurorinë Themelore në Prishtinë është krijuar në pajtim me Planin strategjik 2016-2019 për ngritjen e efikasitetit në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike në sistemin prokurorial.

Ngarkesa me lëndë në fund të vitit 2020 rezulton të jenë zvogëluar për 63 kallëzime penale (apo -27.39%) dhe 100 persona (apo -19.27%) në raport me ngarkesën më lëndë në fillim të vitit.

#### 4.2 SUBJEKTET PARASHTRUESE TË KALLËZIMEVE PENALE (KORR & E)

Subjektet parashtruese gjatë vitit 2020 kanë parashtruar në Njësitin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë gjithsej **226** kallëzime penale me **405** persona të përfshirë në veprat penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike (shih figurën 26).

SUBJEKTET		KORRUPSIONI		KRIMET EKONOMIKE		GJITHSEJ:	
		R	P	R	P	R	P
1	AKK	45	89	1	1	46	90
2	ATK	1	1	16	16	17	17
3	IPK	5	6	5	8	10	14
4	OAK	1	1			1	1
5	DG			35	37	35	37
6	PK	21	45	38	80	59	125
7	TP	8	8	5	7	13	15
8	EPK	11	29	5	15	16	44
9	PV	5	9	4	8	9	17
10	Q	5	9			5	9
11	ID	15	36			15	36
<b>Gjithsej</b>		<b>117</b>	<b>233</b>	<b>109</b>	<b>172</b>	<b>226</b>	<b>405</b>

Figura 26

